

VENDIM
Nr. 640, datë 6.11.2017

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
TUNIZISË, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Tunizisë, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TUNIZISË PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT
E PASAPORTAVE DIPLOMATIKE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Tunizisë, më poshtë të referuara si Palët Kontraktuese,

Duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetasit e të dyja Palëve Kontraktuese, mbajtës të pasaportave të vlefshme diplomatike, do të hyjnë në territorin e palës tjetër kontraktuese pa vizë dhe do të qëndrojnë për një periudhë maksimale prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e hyrjes.

Neni 2

1. Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të pasaportave diplomatike, të dërguar për të punuar si anëtarë të misioneve diplomatike dhe posteve konsullore, si dhe organizatave ndërkombëtare të vendosura në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese, do të lejohen të hyjnë pa viza në territorin e shtetit të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Dispozitat e paragrafit 1) zbatohen edhe për anëtarët e familjeve të tyre që banojnë me ta në të njëjtën familje dhe zotërojnë pasaportë të vlefshme diplomatike.

Neni 3

Shtetasit e secilës Palë Kontraktuese, mbajtës të një pasaporte të vlefshme diplomatike, do të hyjnë, dalin ose kalojnë tranzit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese në çdo pikë kalimi kufitar të caktuar për trafik ndërkombëtar.

Neni 4

1. Shtetasit e njërës Palë Kontraktuese, mbajtës të një pasaporte diplomatike, do të respektojnë ligjin dhe rregulloret e Palës tjetër Kontraktuese gjatë qëndrimit në territorin e asaj Pale.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën e Palëve Kontraktuese për të refuzuar hyrjen ose anulimin e qëndrimit për shtetasit e Palës tjetër, të cilët ajo mund t'i konsiderojë si persona *non grata*.

Neni 5

1. Me synimin për të mbrojtur sigurinë kombëtare, paqen dhe rendin publik, si dhe shëndetin e shtetasve të tyre, Palët Kontraktuese do të kenë të drejtë të pezullojnë zbatimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën në lidhje me vendimin për pezullimin e kësaj marrëveshjeje pjesërisht ose plotësisht, ose për rihyrjen në fuqi nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 6

1. Palët do të shkëmbejnë specimene të pasaportave të tyre diplomatike përkatëse të vlefshme brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për ndryshimin e këtyre specimeneve gjashtëdhjetë (60) ditë para se ndryshimi të hyjë në fuqi.

3. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë specimene të pasaportave diplomatike të reja ose të ndryshuara, duke përfshirë të dhëna në lidhje me përdorimin e tyre të paktën tridhjetë (30) ditë para paraqitjes së specimeneve.

Neni 7

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjes do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 8

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. Secila Palë Kontraktuese mund të ndërpresë në çdo kohë marrëveshjen, duke i dërguar njoftim me shkrim Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky përfundim do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Palët Kontraktuese, me pëlqim të ndërsjellë, mund të paraqesin ndryshime dhe shtesa në këtë marrëveshje. Këto ndryshime do të përbëjnë pjesë përbërëse të kësaj marrëveshjeje dhe do të hyjnë në fuqi sipas të njëjtës procedurë të përcaktuar në nenin 9 të kësaj marrëveshjeje.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit Pala Kontraktuese njofton Palën tjetër Kontraktuese, nëpërmjet kanaleve diplomatike, se janë përmbyshur të gjitha kërkesat ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në dëshmi të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkruar, të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë marrëveshje.

Nënshkruar në Nju-Jork, më 19.9.2017, në dy kopje në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze. Në rast mosmarrëveshjeje në lidhje me interpretimin, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ditmir Bushati
MINISTËR PËR EUROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS
SË TUNIZISË

Khemais Jihaoui
MINISTËR I PUNËVE TË JASHTME